



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË**

Nr. 19184 Prot.

Lezhë, më 04 . 11 . 2025

VENDIM

Nr. 93, Datë 30. 10. 2025

PËR MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIT TË QIRASË, TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË PËR VITIN 2025

Në mbështetje të nenit 8, nenit 24 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, nenit 2 pika 36 dhe nenit 38, të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, pika 4/a VKM nr. 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, Vendimit nr. 18517/1 prot., datë 20.10.2025 të Komisionit të Strehimit, për “Miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë, të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2025”, vlera të cilat do të zbatohen në programin e subvencionit të qirasë për vitin 2026, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

1. Miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë, të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2025, si më poshtë vijon:
 - Qiraja mesatare për strukturën e apartamentit 1+1, është 18 250 (tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë.
 - Qiraja mesatare për strukturën e apartamentit 2+1, është 25 100 (njëzet e pesë mijë e njëqind) lekë.
 - Qiraja mesatare për strukturën e apartamentit 3+1, është 30 700 (tridhjetë mijë e shtatëqind) lekë.
2. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë është e barazvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë, sipas vlerave të paraqitura në këtë vendim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI
NDUE LULI**





Nr. 13184/1 prot
Dt: 07.11.25
K.B

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1059/ Prot.
12

Lezhë, më 07.11.2025

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr. 107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; ligjin nr. 22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar; VKM-në nr. 362, datë 29.5.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij" të ndryshuar, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 93, datë 30.10.2025 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë, të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2025".

P R E F E K T I

Taulant MALSHI

